



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

**Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

**Nr. K3/XH1 – 8 Prot.
Nr. Dok. 202502311/8**

Tiranë 11/12/2025

Lënda: Rekomandim për: (I) Marrjen e masave të menjëhershme të heqjes së statusit si abonent debitor nga sistemi i menaxhimit të abonentëve të shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a., të ankuesit z. Xh. Sh., si dhe

(II) Plotësimin e detyrimit ligjor për dhënien e informacionit Avokatit të Popullit si dhe për fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve përgjegjës të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a. Tiranë, për mungesë bashkëpunimi.

**FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL SH.A
DEPARTAMENTIT TË MARRËDHËNIEVE ME KLIENTIN**
Blv. "Gjergj Fishta", nd. nr. 88, h. nr. 11, Nj.A. nr. 7, 1023

TIRANË

OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES OSSH SH.A
Lagj "Kushtrimi", Rruga "Gjergj Kastrioti", pranë ish-Frigoriferit

VLORE

OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES OSSH SH.A
Blv. "Gjergj Fishta", nd. nr. 88, h. nr. 11, Nj.A. nr. 7, 1023

TIRANË

**ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË
DREJTORISË SË MBROJTJES SË KONSUMATORIT, PERFORMANCËS DHE
STANDARDEVE**
Blv. "Bajram Curri", rr. Viktor Eftemiu, 1023

TIRANË

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit, në ushtrim të kompetencave kushtetuese ligjore, në mbrojtje të të drejtave, lirive themelore të shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe interesave të tyre të ligjshme, ka marrë në shqyrtim ankesën e shtetasit z. Xh. Sh., i cili parashtron shqetësimin dhe pretendimin e tij se është vënë në dijeni në gusht të vitit 2024 për një detyrim si debitor për 78 kontrata të kategorisë familjare, mbi një objekt të shpronësuar dhe të prishur që në vitin 2013.

Konkretisht, sipas shpjegimeve të ankuesit, shpronësimi dhe prishja e objektit të ekzekutuar në dhjetor të vitit 2013, është kryer në zbatimin të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1015, datë 27.11.2013 “Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, objektet, që preken nga rehabilitimi mjedisor i vijës së mbrojtur bregdetare, Ujë i Ftohtë - tuneli, Bashkia e Vlorës”.

Gjithashtu, z. Xh. Sh. në periudhën gjatë pjesës së mbetur të vitit 2013 nga momenti i zbatimit të VKM-së dhe gjatë vitit 2014 ka aplikuar për lidhje të reja pranë shoqërisë që ofron shërbimin universal të furnizimit me energji elektrike dhe nuk i është komunikuar asnjë pa rregullsi lidhur me 78 kontratat e objektit të prishur. Ndërkohë në ditët e sotme ankuesi, pas thaujse 12 vite, njoftohet se është debitor ndaj së njëjtës shoqërie e cila më parë nuk e ka njoftuar asnjëherë për një fakt të tillë.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ankuesi, rezulton se z. Xh. Sh. më datë 09.09.2024 ka depozituar ankesë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të OSHEE sh.a Tiranë ku ka sqaruar se objekti, për të cilat ishin aktivizuar 78 kontrata të kategorisë familjare, është demoluar në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1015, datë 27.11.2013 “Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, objekte, që preken nga rehabilitimi mjedisor i vijës së mbrojtur bregdetare, Ujë i ftohtë - Tuneli, Bashkia e Vlorës”.

Ndërkohë Sektori i Matjes Njësia Vlorë, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a, me shkresën nr. 1930/1 prot., datë 18.12.2024, në “Kthim përgjigje” Departamentit të Matjes dhe Mbështetjes së Tregut, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a, sqaron se: “...referuar sistemit mPower për 78 (shtatëdhjetë e tetë) kontrata në emër të z. Xh. Sh. rezulton se nuk është regjistruar asnjë kërkesë për Mbyllje Kontrate. Lidhur me pretendimin për demontimin e matësve nga grupi i zonës më datë 28.11.2013, është një periudhë e hershme dhe në arkivë nuk disponohet asnjë dokumentacion.”.

Në këtë kontekst, ankuesi ka kërkuar ndërhyrjen nga ana e Avokatit të Popullit, për sqarimin dhe zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështjeje.

Për këtë, pas regjistrimit të kësaj ankese, institucioni i Avokatit të Popullit, ka konstatuar se ankesa plotëson të gjithë kushtet thelbësore si në aspektin formal ashtu edhe në atë substancial për t’u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, ndaj bazuar në nenet 13, 17 shkronja “a” dhe 18, shkronja “b”, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ka vendosur ta pranojë ankesën dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes.

1. Rrethanat dhe faktet e njohura publikisht

- Pas përfundimit të ndërtimit të objektit “Kompleksi Jon”, z. Xh. Sh. ka çelur 78 kontrata për marrjen e shërbimit të furnizimit me energji elektrike pranë shoqërisë që e ofronte këtë shërbim, në mënyrë që më tej të kalonin në emër të subjekteve të treta, të njësive individuale, blerës/pronarë.

- Në datën 03.11.2013 nga ana e inspektorëve të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar dhe të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor Vlorë, janë ndërmarrë veprime administrative që konsistojnë në rrethimin e të gjithë kompleksit ndërtimor me qëllim shembjen e të gjithë godinës në mënyrë të menjëhershme, për shkak se sipas Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, leja e ndërtimit për këtë ndërtesë është dhënë në kundërshtim me ligjin.

- Më 27 nëntor 2013, Këshilli i Ministrave shpalli një vendim, i cili hyri në fuqi menjëherë, duke urdhëruar shpronësimin në interesin publik të pronave private të paluajtshme të ndikuara nga rehabilitimi mjedisor i Ujit të Ftohtë, Tuneli; një vijë bregdetare e mbrojtur në Bashkinë Vlorë. Konkretisht VKM nr. 1015, datë 27.11.2013 “Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, objektet, që preken nga rehabilitimi mjedisor i vijës së mbrojtur bregdetare, Ujë i Ftohtë - tuneli, Bashkia e Vlorës” u publikua në Fletoren Zyrtare më 3 dhjetor 2013. Shpronësimi u bë në favor të Bashkisë Vlorë brenda tridhjetë ditëve të vendimit.

- Më 28 nëntor 2013, Kryeministri deklaroi publikisht se qeveria synonte të realizonte një projekt për ndërtimin e Lungomares.

- Më 2 dhjetor 2013, kryetari i Bashkisë Vlorë, kërkoi ndihmën e INUK-ut për shembjen e Rezidencës Jon, sipas vendimit të datës 27 nëntor 2013. Në po të njëjtën ditë, INUK-u kërkoi ndihmën e policisë së Vlorës për shembjen, e cila ishte planifikuar të fillonte në orën 8 të paradites, në mëngjesin e ditës tjetër. E gjithë godina u shemb duke e hedhur në erë me dinamit, nga data 4 dhjetor 2013 deri më 8 dhjetor 2013

Nga sa sipër rasti në fjalë ka qenë më se i njohur edhe mediatikisht për faktin se objekti ka qenë me leje dhe u prek nga gjurma e realizimit të projektit të Lungomares.

Strukturat përgjegjëse të ngarkuara për zbatimin e këtij vendimi të Këshillit të Ministrave kanë qenë Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministria e Mjedisit, Ministria e Financave dhe bashkia e Vlorës. Edhe sot nëse bën një kërkim të thjeshtë në motorin e kërkimit, psh. Google, me fjalët kyçe “Kompleksi Jon” dalin pamjet e ngjarjes së pazakontë. Qëllimi fundor i VKM nr. 1015, datë 27.11.2013 ishte kalimi i pronësisë së objektit nga bashkëpronarët tek Bashkia Vlorë.

Të gjitha veprimet e sa më sipër renditur afektuan edhe proceset e rregullta ligjore për të cilat banorët u pamundësuan për t’i kryer ato.

Rasti në fjalë është bërë objekt i procedurave gjyqësore sipas legjislacionit vendas, por edhe ato të mbrojtjes së të drejtave të njeriut sipas Konventës së të Drejtave të Njeriut. Për këtë më poshtë sjellim evidentime të proceseve gjyqësore nga vendime të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë dhe të vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) në çështjen e cila mban emrin e vetë ankuesit “Sharxhi dhe të tjerët Kundër Shqipërisë”, konkretisht:

- Vendimi nr.00-2024-152 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në parashtrimin e rrethanave, vëren në se: paragrafi 23 “...Gjykata Administrative e Apelit, në referencë të parashikimeve ligjore që evidentohen në ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” vlerëson se bllokimi i objektit që deri përpara shembjes ndodhej në pronësi të paditësve, është kryer në kundërshtim të hapur me ligjin. Bllokimi i objektit dhe ndalimi i hyrjes së personave në të përbën një ndër masat urgjente që mund të marrin inspektorët gjatë inspektimit që kryejnë.”; paragrafi 24 “...pala e paditur (Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territori (ish Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar)) kishte detyrimin që vullnetin e saj, jo vetëm ta materializonte në një akt formal, vendim të ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente, por duhej që ky vendim të pasqyrohej në procesverbal dhe t’i njoftohej subjektit, pa vonesë, në mënyrë verbale, detyrim ky i cili nuk rezulton të jetë përmbushur në rastin konkret.”

- Vendimi Nr. 00-2022- 1191 i Vendimit (234) i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në parashtrimin e rrethanave, vëren se: paragrafi 61 “Gjatë seancës, përfaqësuesi i kërkuesve deklaroi se më 9 dhjetor 2013, kërkuesit kishin parashtruar një kërkesë për kompensim në Bashkinë Vlorë. Më 20 janar 2014, Bashkia Vlorë u kishte kërkuar kërkuesve të sillnin një kopje të certifikatës së pronësisë së bashku me hartën e apartamenteve të lëshuar nga ZRRPP-ja, brenda 72 orëve të fundit. Kërkuesit nuk i paraqitën këto dy dokumente. Më tej, ata parashtruan se ZRRPP-ja kishte refuzuar të lëshonte certifikatat”; paragrafin nr. 82 “Gjykata vëren se kërkuesit u ankuan për konfiskimin dhe rrethimin e godinës si në procedimet e përkohshme dhe në ato kryesore, në lidhje me veprimet e datës 3 nëntor 2013, dhe se gjykatat vendëse, në përputhje me rrethanat, morën një vendim për kërkesat e tyre, duke nënvizuar se ata ishin ndaluar të hynin në shtëpitë e tyre...”; paragrafin 88. “Gjykata vëren se, ashtu siç përcaktohet nga gjykatat vendëse, si pasojë e faktit se kërkuesve iu ishte refuzuar akses i në pronat e tyre për një periudhë njëmuajore, nga data 3 nëntor deri më 4 dhjetor 2013, ata humbën efektivisht kontrollin e plotë mbi pronat e tyre, si edhe mundësinë për t’i përdorur dhe për t’i gëzuar ato. Mohimi i vazhdueshëm i aksesit për një periudhë njëmuajore, kështu, duhet të konsiderohet si një ndërhyrje në të drejtat e tyre sipas nenit 1 të protokollit nr. 1.”; paragrafin 96 “Gjithashtu, Gjykata vëren se edhe pse kërkuesit nuk parashtruan kërkesën e dorëzuar në Bashkinë e Vlorës ku kërkuesit në Gjykatë shlyerjen e kompensimit, ata gjithsesi e dorëzuan përgjigjen e ZRRPP, të datës 29 janar 2014, ku pohojnë se ajo e kishte të pamundur të lëshonte një certifikatë pronësie për një pronë e cila nuk ekzistonte më. Rezulton se autoritetet kishin kërkuar certifikatat e pronësisë së kërkuesve si dokument mbështetës, në momentin kur ata kërkuan kompensim. Gjykata vëren se, sipas aktit të shpronësimit, u takon autoriteteve të nisin procedimet përkatëse të kompensimit (shih paragrafin 63 më sipër). Për këtë arsye, Gjykata mendon se, të të tillë çështje, nuk duhet të pritet që pronarët të pësojnë shpenzimet dhe barrën

e procedimeve të fillimit për të garantuar përmbushjen nga ana e autoriteteve të detyrimit të tyre ligjor...

- “Çështja Sharxhi dhe të tjerët kundër Shqipërisë” (kërkesa nr. 10613/16), Vendim i GJEDNJ-së, Strasburg më datë 11 janar 2018, i formës së prerë më datë 28.5.2018, ka gjetur shkelje të shtetit shqiptar të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut¹:

- > Shkelje të Nenit 6§1 i konsideruar i mëveçantë dhe së bashku me Nenin 13 të Konventës.
- > Shkelje të Nenit 8 i konsideruar i mëveçantë dhe së bashku me Nenin 13 të Konventës.
- > Shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës veçantë dhe së bashku me Nenin 13 të Konventës

Për këto shkelje GJEDNJ për Shqipërinë ka vendosur që shteti i paditur duhet t’u paguajë kërkesve, dëmshpërblimin për shkeljen e të drejtës së pronës por edhe të ekzekutimit të pjesshëm të VKM-së nr. 1015, datë 27.11.2013. Konkretisht vlerën në lidhje me marrjen e pronës nga pronarët e ligjshëm por pa realizuar detyrimin e shpërblimit të drejtë për shpronësim.

Pra aktualisht ankuesi, i cili në vitin 2013 u zhvesh nga të gjitha të drejtat reale mbi pronësinë e pasurisë së paluajtshme nga zbatimi i VKM-së nr. 1015, datë 27.11.2013, sikurse dhe të gjithë bashkëpronarët e tjerë, sot nuk ka asnjë lidhje, të asnjë lloj forme, me objektin, që të mund të njihet qoftë në aspektin e rregullimit ligjor të zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë apo në normat e pashkruara të shoqërisë shqiptare, i cili nuk ekziston as *de facto* dhe as *de jure*.

2. Vlerësimi i Avokatit të Popullit

¹ https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/convention_sqj

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut parashkinon në:

Neni 6 “E drejta për një proces të rregullt” 1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t’i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.

Neni 8 “E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare” 1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. 2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.

Neni 13 “E drejta për zgjidhje efektive” Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

Protokolli 1 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, Neni 1 “Mbrojtja e pronës” Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk çmojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.

2.1. Hetimi nga Avokati i Popullit

Në zbatim të detyrimit kushtetues e ligjor, e konkretisht nenit 63, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: *“Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”*, si dhe nenit 19 shkronja “b”, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”*, në vijim të hetimit administrativ me qëllim sqarimin e fakteve e të rrethanave, me shkresën nr. K3/XH1 – 2 prot., datë 14.02.2025, *“Kërkesë për shpjegime dhe dokumentacion”* kemi kërkuar nga ana e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a, Vlorë dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a, Tiranë dërgimin e shpjegimeve lidhur me arsyet ligjore që kanë vënë në pozitë debitori ankuesin si dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit ligjor që e justifikon këtë situatë.

Në përgjigje tonës me shkresën nr. 196/1 prot., datë 17.03.2025, Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a, Rajoni Vlorë, na informon se: *“... Sipas të dhënave në sistemin e faturimit, që përfaqëson bazën e të dhënave të shoqërisë sonë, rezulton se konsumatorët janë të regjistruar vetëm me emër, mbiemër dhe jo me atësi. Në bazë të kushteve rregullatorë të mëparshme konsumatorët nuk ishin të detyruar të paraqisnin të dhëna të detajuara personale apo një kopje të dokumentit zyrtar të identifikimit. Me gjeneralitetet Xh. Sh. referuar të dhënave sistemit të faturimit rezulton të jenë 78 (shtatëdhjetë e tetë) abonentë dhe të kenë kontratë të furnizimit me energji elektrike me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a në Rajonin Vlorë...Referuar të dhënave të sistemit mPower nuk rezulton të ketë kërkesë/ankesë të depozituar për këto kontrata.”*

Duke qenë se përgjigja e dhënë nuk rezultonte të ishte e plotë dhe shteruese, iu ridrejtua me shkresën nr. K3/XH1 – 5 prot., datë 23.04.2025, *“Kërkesë për shpjegime dhe dokumentacion”* Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a, Tiranë, Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a, Tiranë dhe Entit Rregullator të Energjisë.

Në përgjigje tonës, me shkresën nr. 1167/1 prot., datë 07.05.2025, Drejtoria e Çështjeve Konsumatore, në Entin Rregullator të Energjisë, na informon se: *“...Lidhur me sa sipër, ju informojmë se pranë Entit Rregullator të Energjisë nuk është regjistruar asnjë ankesë zyrtare nga ana e z. Xh. Sh.. ERE, në përputhje me kompetencat e saj ligjore dhe procedurat administrative në fuqi, shqyrton ankesat individuale të konsumatorëve vetëm pas paraqitjes së tyre zyrtare, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës. Lidhur me detyrimin kontraktual prej 240 lekë/muaj, ju sqarojmë se ky detyrim është i miratuar në përputhje me vendimet përkatëse të Bordit të ERE-së për çmimet dhe tarifat e energjisë elektrike, të bazuara në “Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, miratuar me Vendimin nr. 182, datë 16.11.2017. Koncretisht kjo tarifë është e njohur si tarifa fikse e shërbimit për leximin zero, dhe vlera e miratuar nga ERE, pa llogaritur TVSH është në masën e 200 lekë në muaj. Ky tarifim përfaqëson një tarifë fikse mujore për shërbimet e shpërndarjes dhe është e zbatueshme për të gjithë përdoruesit e rrjetit të*

shpërndarjes në përputhje me legjislacionin në fuqi. Enti Rregullator i Energjisë mbetet i angazhuar për respektimin e të drejtave të konsumatorëve dhe është i gatshëm të trajtojë çdo ankesë që mund të paraqitet në mënyrë zyrtare nga palët e interesuara.”

Në mungesë të një përgjigje nga shoqëritë e tjera, iu ridrejtua me shkresën nr. K3/XH1 – 7 prot., datë 12.06.2025, “Kërkesë e përsëritur për shpjegime dhe dokumentacion” Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a, Tiranë (FSHU sh.a. Tiranë) dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a, Tiranë (OSSH sh.a. Tiranë). Evidentojmë faktin se institucionet e sipërcituara nuk përcollën asnjë përgjigje zyrtare pranë Avokatit të Popullit.

Ritheksojmë edhe një herë se kërkesat e parashtruara në shkresat për të cilat institucioni i Avokatit të Popullit nuk ka marrë përgjigjen zyrtare, i referohen:

- se përse Sektori i Matjes Njësia Vlorë, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a, me shkresën nr. 1930/1 prot., datë 18.12.2024, në “Kthim përgjigje” Departamentit të Matjes dhe Mbështetjes së Tregut, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a, shprehet që: *“Lidhur me pretendimin për demontimin e matësve nga grupi i zonës më datë 28.11.2013, është një periudhë e hershme dhe në arkivë nuk disponohet asnjë dokumentacion.”*, dhe

- se si mund të konsiderohet zbatim i rregullt i kontratës, në kuptim të nenit 678, të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, ku “Objekti i kontratës” *duhet të jetë 1) i mundshëm, 2) i ligjshëm, 3) i caktueshëm ose 4) që mund të përcaktohet* në kushtet kur objekti i kësaj kontratë është null, është zhbërë, pasi ka 12 vite që është zbatuar VKM nr. 1015, datë 27.11.2013 “Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, objektet, që preken nga rehabilitimi mjedisor i vijës së mbrojtur bregdetare, Ujë i Ftohtë - tuneli, Bashkia e Vlorës”. Nga sa sipër dhe referuar edhe realitetit fizik në ditët e sotme, ky objekt, kjo pronësi për të cilën më 17-18 korrik 2013 janë aktivizuar 78 kontrata për marrjen e shërbimit me furnizim me energji elektrike, për kategorinë familjare, nuk ekziston *de facto* dhe *de jure*.

2.2. Lidhur me zbatimin në rastin konkret të kuptimit të kontratës sipas Kodit Civil

Sjellim në vëmendje se, në kuptim të nenit 678, të Kodit Civil, midis abonentëve dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal, objekti i kontratës është furnizimi me energji elektrike. Konsumi i energjisë për të 78 abonentët me gjeneralitetet Xh. Sh., matet nëpërmjet matësve në përputhje me Kodet e Rrjetit dhe në zbatim të Kodit të Matjes. Në këtë kontest lind natyrshëm dyshimi se si dhe se deri kur është zbatuar ky detyrim nga ana e shoqërisë që ofron shërbimin e furnizimit me energji elektrike, për rastin në fjalë.

Pra, “Kontrata” nuk ka për qëllim të krijojë detyrimin pa dhënë shërbimin.

Bëjmë me dije se edhe pse tashmë Avokati i Popullit ka adresuar këto shkresa pranë organeve të sipërcituara publike, në të cilat parashtrohen kërkesat për shpjegime mbi trajtimin e çështjes së paraqitur në ankesën e z. Xh. Sh., informojmë se sot e kësaj dite nuk ka asnjë përgjigje dhe asnjë reagim zyrtar nga ana juaj, duke gjeneruar kështu një situatë të pazakontë, e cila ka ndikuar në afatet e shqyrtimit të kësaj çështjeje nga ana e institucionit tonë.

Efektivisht sot, vijimi i shqyrtimit të kësaj çështjeje nga ana e Avokatit të Popullit, është vështirësuar nga mungesa e gatishmërisë dhe e bashkëpunimit prej personave përgjegjës në FSHU sh.a Tiranë dhe OSSH sh.a, për dhënien e shpjegimeve për kërkesat dhe vënies në dispozicion të kopjes së dokumentacionit zyrtar të kërkuar.

Duke pasur parasysh dinamikën e këtij rasti gjatë hetimit administrativ nga ana jonë, vlerësojmë dhe theksojmë se, mënyra e trajtimit të kësaj çështjeje nxjerr në pah se vendosja në mënyrë fiktive si debitor i ankuesit, z. Xh. Sh., vijon të aplikohet dhe favorizohet nga shoqëria e cila menaxhon sistemin e matjes së energjisë elektrike mPower me qëllim përkeqësimin edhe më tej të pozitës së ankuesit, kjo e vërtetueshme edhe nga shuma e përlllogaritur fiktivisht e të gjithë kontratave.

Në këtë optikë, referuar zbatimit të kuadrit ligjor të zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, si garantuesi dhe rregullatori i shoqërisë, lind nevoja të bëhet një pasqyrim i ndërthurur i dispozitave që parashikojnë rregullimin e marrëdhënieve që lindin nga kontratat, për trajtimin e rastit konkret.

- 1- Ligji nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon, si më poshtë vijon:
 - a) neni 678 “Objekti i kontratës” *Objekti i kontratës duhet të jetë i mundshëm, i ligjshëm, i caktueshëm ose që mund të përcaktohet.*
 - b) neni 681 *Kur interpretohet një kontratë, duhet të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para e pas përfundimit të kontratës.*
 - c) neni 682 *Kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit. Kontrata duhet të interpretohet në mirëbesim nga palët.*
 - d)
 - e) Neni 700 *Pala kontraktuese mund të njoftojë me shkrim palën tjetër që nuk ka përmbushur detyrimin, që ta përmbushë atë në një afat të përshtatshëm, duke deklaruar se, po qe se pas këtij afati kontrata nuk ekzekutohet, ajo do të quhet patjetër e zgjidhur.*
 - f)
 - g) Neni 772 *Furnizimi është një kontratë me të cilën njëra palë detyrohet, kundrejt pagesës së një çmimi, të kryejë në dobi të palës tjetër furnizime periodike ose të vazhdueshme të sendeve. Sendet e furnizuar mund të jenë të luajtshme ose të paluajtshme, gjithashtu mund të jenë në trajtë energjie ose titujsh krediti.*

Në bazë të rregullimeve të përcaktuara nga Kodi Civil mbi kontratën, të 78 kontratat e çelura për furnizimin me shërbimin e energjisë elektrike, më 17-18 korrik 2013, kanë qenë sipas

modelit tip të kontratës² së miratuar me Vendim të ERE-s nr. 108, datë 21.10.2011³. Në nenin 5 të kësaj kontrate parashikohet “Pezullimi dhe Përfundimi i Kontratës” 5.1 *Kontrata e furnizimit lidhet për një periudhë të pacaktuar dhe mund të ndërpritet vetëm në rastet e parashikuara si më poshtë:...* 5.1.2 *Me iniciativën e Furnizuesit, në rast të shkeljes nga ana e Klientit të detyrimeve thelbësore të kontratës. Do të konsiderohen shkelje thelbësore të kushteve të kontratës nga ana e Klientit rastet si më poshtë: a- Nëse Klienti nuk paguan detyrimet e energjisë elektrike duke përfshirë edhe kamatëvonesën brenda 1 muaji pas ndërprerjes së energjisë elektrike. b- Nëse provohet nga Furnizuesi që Klienti merr energji elektrike në mënyrë të paligjshme. c- Nëse Klienti, në mënyrë të përsëritur, nuk i krijon akses Furnizuesit për më shumë se 3 muaj për leximin e verifikimin e matësave dhe instalimeve, kur matësi apo sistemi i matjes është brenda kufijve të pronës të tij. ...5.4 *Me ndërprerjen e kontratës së furnizimit me energji elektrike, Furnizuesi do të ndërpresë menjëherë furnizimin e energjisë elektrike në pikën e lidhjes. Me ndërprerjen e lidhjes, Furnizuesi do të bëjë leximin dhe do të llogarisë faturën e fundit, si edhe do të vulosë pikën e shkëputjes, duke përdorur një vulë të ndryshme nga ajo e lidhjes në përputhje me legjislacionin në fuqi.”**

2.3. Lidhur me efektet e zbatimit të VKM nr. 1015, dt. 27.11.2013, “Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, objektet, që preken nga rehabilitimi mjedisor i vijës së mbrojtur bregdetare, Ujë i Ftohtë - tuneli, Bashkia e Vlorës”

Më 27 nëntor 2013, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin nr. 1015, “Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, objektet, që preken nga rehabilitimi mjedisor i vijës së mbrojtur bregdetare, Ujë i Ftohtë - tuneli, Bashkia e Vlorës”, i cili hyri në fuqi menjëherë, duke urdhëruar shpronësimin në interesin publik të pronave private të paluajtshme të ndikuara nga rehabilitimi mjedisor i Ujit të Ftohtë, Tuneli. Rrjedhimisht ankuesi z. Xh. Sh. dhe të gjithë bashkëpronarët e tjerë të objektit, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi pas publikimit në Fletoren Zyrtare më 3 dhjetor 2013, nuk kishin titull pronësie dhe nuk kryenin dot veprime mbi objektin e banimit, pallatin, në të cilin kishin apartamentet e tyre. Për më tepër i gjithë objekti është shembur në harkun kohor nga data 4 - 8 dhjetor 2013.

Në zbatim të VKM-së nr. 1015, datë 27.11.2013, të gjithë pronarët e objektit u shpronësuan me qëllim që ky objekt të kalojë në pronësi me pronar shtet sikurse është aktualisht. Në këto rrethana është lehtësisht e kontestueshme dhe e kuptueshme që legjitimiteti për të kryer veprimet e mëtejshme, ku përfshihej edhe veprimi i ndërprerjes së kontratave të çelura në 17-18 korrik 2013 në objektin e shpronësuar dhe që i kaloi shtetit në pronësi, duhet të ishin dhe duhet të konkludoheshin me pronarin shtet.

Pra shoqëria dhe autoritetet përgjegjëse jo vetëm që kanë dështuar të verifikojnë dhe të provojnë ligjshmërinë e mungesës së ekzistencës të objektit de facto dhe de jure ku kanë qenë të instaluar 78 matësat e 78 kontratave të abonentëve me adresë në Uji i ftohtë, Vlorë, të cilat marrin “ushqim” edhe në 2025, nga kabina Plazh i Ri me fider Q1/R549, 1 fazor dhe me fuqi të kërkuar 5/7 kW, duke vijuar të mbajnë përgjegjës ligjor për pagesën e energjisë elektrike

² https://oshee.al/wp-content/uploads/2013/08/kontrata_per_konsumatoret_familjare.pdf

³ https://www.ere.gov.al/images/archive/VENDIM_NR.108_2011-1.pdf

ankuesin i cili, theksojmë se, pas ekzekutimit të VKM-së nr. 105/2013, nuk vijon të ketë *de jure* dhe *de facto* pronësi mbi objektin e shpronësuar, por nuk ka kryer asnjë procedurë apo ndërmarrë ndonjë veprim për ndërprerjen e këtyre kontratave me pronarin shtet.

Më tej, po në kontratën tip të miratuar sipas vendimit të ERE-s nr. 108, datë 21.10.2011, neni 15 “Furnizimi dhe karakteristikat e energjisë elektrike” në pikën 15.1 përcaktohet specifikisht se: *Furnizuesi do të sigurojë furnizimin të pandërprerë dhe me cilësi të energjisë elektrike. **Furnizuesi mund të ndërpresë furnizimin e energjisë elektrike në rastet e mëposhtme:** a. Për shkaqe të forcës madhore - ndërprerje të shkaktuara nga ngjarje të jashtëzakonshme natyrore **dhe përcaktimeve të tjera sipas ligjit.** b. Ndërprerje për shkak të urdhrave të Operatorit të Sistemit të Transmetimit; c. Për efekt të garantimit të sigurisë së jetës, shëndetit dhe pasurisë së personave; d. Ndërprerje të planifikuara, për kryerjen e punimeve të mirëmbajtjes, remonteve të programuara të linjave dhe pajisjeve të Sistemit të Shpërndarjes, duke njoftuar paraprakisht sipas afateve të përcaktuara në Rregulloren e Cilësisë së Shërbimit; e. Ndërprerje të paplanifikuara (të shkurtra apo të gjata) - për shkak të defekteve dhe dëmtimeve të linjave dhe pajisjeve të Sistemit të Shpërndarjes.*

Sjellim në vëmendje se, nisur nga sa sipër, evidentohet qartësisht mosrespektim i kushteve kontraktuale nga ana e furnizuesit të shërbimit dhe më saktësisht të parashikimeve të nenit 15, pika 15.1(a), i cili parashikon se furnizuesi mund të ndërpresë energjinë elektrike edhe në rastet e tjera sipas ligjit. Ju bëjmë me dije se pikërisht miratimi i VKM-së nr. 1015, datë 27.11.2013, kualifikohet sipas parashikimeve të pikës 15.1 (a) në kategorinë e ndërprerjes së energjisë elektrike “*përcaktimeve të tjera sipas ligjit*”.

Në këto kushte duhet të ishte furnizuesi i cili sipas këtyre përcaktimeve, duhet të kishte bërë ndërprerjen me furnizim të energjisë elektrike dhe të vijonte procedurën për mbylljen e kontratave familjare të furnizimit me pronarin shtet tashmë, pas zbatimit të VKM-së së sipërcituar e cila u materializua me demolimin e objektit për të cilin këto kontrata furnizimi për energji elektrike ishin nënshkruar fillimisht.

Për më tepër nga ana e shoqërisë që ofron furnizimin e shërbimit, që nga dhjetor 2013, objekti ku kanë qenë të instaluar matësat e 78 kontratave, nuk ekziston më as *de facto* e në këtë kontekst shprehemi se shoqëria që ofron furnizimin e shërbimit universal me energji elektrike ndodhet në shkelje të flagrante, në mënyrë arbitrare të dispozitave ligjore, si të atyre të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave, dhe parashikimeve detyruese të Kontratës për furnizimin me energji elektrike. Rikujtojmë faktin shumë të rëndësishëm që punonjës të shoqërisë të shpërndarjes së energjisë elektrike kanë kryer veprimet e nevojshme për ndërprerjen dhe moslejimin e kalimit të rrymës së energjisë elektrike në linjat e objektit, ku kanë qenë të instaluar matësat e 78 kontratave, i cili është demoluar me eksploziv.

2.4. Lidhur me statusin aktual të ankuesit si debitor fiktiv (në mënyrë të paligjshme) nga shoqëria që ofron shërbimin e furnizimit me energji elektrike

Sjellim në vëmendje se, në përcaktimet e detyrimeve sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë mbi Parashkrimin dhe Shuarja e Detyrimeve:

- neni 482 parashikon se: Debitori që është në vonesë nuk çlirohet nga pamundësia e papritur e përmbushjes së detyrimit, edhe sikur kjo të jetë shkaktuar pa fajin e tij e të kreditorit, përveç kur provon se objekti i detyrimit do të ishte shkatërruar apo dëmtuar edhe sikur të ishte nën kujdesin e kreditorit.

duke rikujtuar se mosekzistenca e objektit për të cilin u lidhën 78 kontratat, për të marrë shërbimin e furnizimit me energji elektrike, është pasojë direkte e zbatimit të VKM-së nr. 1015, datë 27.11.2013. Pra edhe sikur të ishim në kushtet kur ankuesi të ishte pronar (i cili nuk kualifikohet ligjërisht si i tillë as *de jure* dhe as *de facto*) sërish do të duhej të mos aplikohet detyrimi për pagesën e energjisë elektrike përfshirë dhe pagesën fikse të mirëmbajtjes prej 240 lek/muaj, duke qenë se tashmë objekti i detyrimit për të cilin u nënshkruan kontratat përkatëse, nuk ekziston më fizikisht.

Pra, “Kontrata”, në përmbledhje të logjikës së saj dhe përcaktimeve sipas Kodit Civil, nuk ka për qëllim të krijojë detyrim pa dhënë shërbimin. Fakti që nënshkrimi i saj si veprim juridik bëhet nga palët, minimalisht 2 si një nga elementët e domosdoshëm të saj të cilët çojnë në livrimin e mallrave ose realizimin e shërbimeve kundrejt një kundërpaguese, pra marrëdhënie e ndërsjellët, kuptohet, që në rastin konkret dhe për të gjitha rrethanat, nuk mund të ngrihet pretendimi se duhet të kishte qenë ankuesi, z. Xh. Sh. aktualisht fiktivisht i kualifikuar si abonent, për të bërë kërkesë për zgjidhjen e 78 kontratave të çelura.

Rrjedhimisht, për sa shërbimi nuk mund të jepet dhe është më se e qartë që ky shërbim nuk mund të ofrohet pasi mungon sendi, 78 kontratat për të cilat pretendohet se marrin shërbim sot e kësaj dite duhet të ishin çregjistruar.

Gjithashtu, koncepti i mosnjohjes së ligjit apo akteve normative të cilat publikohen në Fletoren Zyrtare, për më tepër, nga një shoqëri e cila vepron për llogari të organeve të administratës qendrore nuk përbën shkak për përjashtim nga përgjegjësia për të vepruar dhe për të përmbushur të gjitha detyrimet.

Për këtë është më se e arsyeshme që të sqarohet se, mospërmbushja e një detyrimi kontraktual, në rastin konkret i prezumuar, sipas ligjit paguhet me vendosjen e një penalteti/ kamatëvonesë (shumë shtesë për pagesë të vonuar, nëse është parashikuar në kontratë) ose me kërkimin gjyqësor të shpërblimit të dëmit.

Kushtet kontraktuale, të nënshkruar në data 17-18 korrik 2013 nga ankuesi, për furnizimin me energji elektrike në neni 11 “Pasojat e mospagesës”, parashikonin qartësisht se: “11.1 Në mungesë të pagesës nga Klienti të faturës brenda 30 ditëve nga kalimi i afatit të caktuar për pagesë sipas neneve 9.1 dhe 10, Furnizuesit i lind e drejta që të bëjë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të Klientit, pasi e ka lajmëruar me shkrim këtë të fundit 48 orë përpara. Furnizuesi është i detyruar që të bëjë rilidhjen brenda 48 orësh nga kryerja e pagesës nga Klienti. 11.2 Në rastet e mësipërme njoftimet bëhen në adresën e përcaktuar në kontratë. 11.3 Nëse Klienti nuk paguan detyrimin që ka ndaj furnizuesit brenda 1 muaji nga data e ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike sipas nenit 11.1, atëherë Furnizuesi ka të drejtë të zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratën e furnizimit me energji elektrike. Në këtë rast Furnizuesi vepron sipas përcaktimeve të nenit 5.4 të kësaj Kontrate.” dhe neni 5 “Pezullimi

dhe përfundimi i kontratës” në pikën 5.4 të tij parashikonte: “5.4 Me ndërprerjen e kontratës së furnizimit me energji elektrike, Furnizuesi do të ndërpresë menjëherë furnizimin e energjisë elektrike në pikën e lidhjes. Me ndërprerjen e lidhjes, Furnizuesi do të bëjë leximin dhe do të llogarisë faturën e fundit, si edhe do të vulosë pikën e shkëputjes, duke përdorur një vulë të ndryshme nga ajo e lidhjes në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

Për këtë, nga ana e shoqërisë që ofron shërbimin universal të furnizimit me energji elektrike, deri më sot nuk rezulton të jetë bërë gjyqësisht kërkesë për shpërblimin e dëmit. Kjo sepse vetë shoqëria nuk ka respektuar in primis kushtet kontraktuale të miratuara nga ERE, sikurse cituara dhe evidentuar sa sipër. Nuk ka njoftuar me shkrim abonentin, si dhe nuk ka bërë zgjidhje të kontratës në mënyrë të njëanshme edhe pse ka kaluar përtej afatit 1 muaj nga data e ndërprerjes me furnizim të energjisë elektrike të 78 kontratave (ndërprerja e energjisë ka ndodhur për shkak të sigurisë publike për të realizuar demolimin e objektit, i cili nuk ekziston më dhe që ishte sendi ku ishin të instaluar matësat e energjisë elektrike për 78 kontratat me gjeneralitetet Xh. Sh.). Gjithashtu furnizuesi nuk ka bërë leximin për të llogaritur faturën e fundit dhe as nuk ka bërë vulosjen në pikën e shkëputjes.

2.5. Lidhur me efektet e faturës si titull ekzekutiv

Më tej, në funksion të analizës tonë, nëse marrim në konsideratë faktin që shoqëria e cila ofron furnizimin e shërbimit universal me energji elektrike është subjekt i tatueshëm në kuptim të ligjit “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, kjo e fundit është e detyruar që për çdo njësi shërbimi që i ka ofruar konsumatorit fundor ta përllogarisë në vlerë monetare dhe për të bërë vjelje të këtij detyrimi emeton “Faturë tatimore”.

Ligji nr. 8662, datë 18.09.2000 “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike”, i ndryshuar⁴, në nenin 1 parashikon se: “*Fatura tatimore e konsumit të energjisë elektrike, sipas modelit të caktuar nga Ministria e Financave, në zbatim të nenit nr. 36, të ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, është titull ekzekutiv.*”

Ligji nr. 92, datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në germën a), të nenit 95 përkufizon se çfarë është fatura “*“Faturë” kuptohet çdo dokument në letër ose në formë elektronike që përmbush kushtet e përcaktuara në këtë ligj dhe neni 101 “Përmbajtja e faturës” përcakton se “Fatura e lëshuar përpilohet në formën e caktuar nga Ministri i Financave dhe përmban informacionin e mëposhtëm:”*”

Edhe nëse do e shohim ngushtësisht në optikën e ligjit që është në fuqi, ligji nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”⁵, të ndryshuar, ku për “Lindja dhe

⁴<https://qbz.gov.al/eli/ligj/2000/09/18/8662/f46b1acc-012a-42a6-ac45-a223fa1ccd72;q=8662%202000>
<https://qbz.gov.al/eli/ligj/2001/02/01/8735/454380b1-26de-438b-b60a-549e31a573fb;q=8662%202000>
(ndryshim i bërë me ligjin nr. 8735, datë 01.02.2001)

<https://qbz.gov.al/eli/ligj/2011/11/26/10486/58d9bb7f-6bce-450b-9118-c30b8d98a95b;q=8662%202000>
(ndryshim i bërë me ligjin nr. 10 486, datë 26.11.2011)

⁵ <https://www.qbz.gov.al/eli/ligj/2014/07/24/92/dd6b7a0e-8727-4741-b5eb-94eef979b49e;q=ligji%207928%20date%2027.04.1995>

Kërkueshmëria e Tatimit për Furnizimet e Mallrave dhe Shërbimeve”, neni 32 “Rregulli i përgjithshëm” parashikon se: “Lindja e tatimit ndodh dhe TVSH-ja bëhet e kërkueshme kur furnizimi i mallrave ose shërbimeve kryhet, përveç kur është parashikuar ndryshe në këtë ligj.”. Ritheksojmë edhe një herë se, në rastin konkret nuk është kryer asnjë furnizim shërbimi me energji elektrike aktive, pasi objekti nuk ekziston tashmë *de facto*, kjo për shkak të zbatimit të VKM-së nr. 1015, datë 27.11.2013.

2.5.1 Lidhur me ofrimin e shërbimit të furnizimit me energji elektrike

Gjithashtu, po në funksion të analizës ligjore, sjellim në vëmendje edhe parashikimet e ligjit nr. 43, datë 30.04.2015, të ndryshuar, “Për sektorin e energjisë elektrike”⁶, Matja e Energjisë Elektrike, më saktësisht dispozitat 76, 78 dhe 81 të cilat përcaktohen si më poshtë:

- Neni 76 “Matja e energjisë elektrike”, parashikon se: “1. Operatorët e sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes janë përgjegjës për veprimtarinë matëse dhe shërbimin e leximit të matësve në rrjetet e tyre përkatëse... 3. Energjia elektrike e hedhur në rrjet ose e furnizuar te klientët fundorë matet nëpërmjet pajisjeve matëse, në përputhje me parashikimet e Kodeve të Rrjetit dhe Kodin e Matjes, si dhe në legjislacionin në fuqi për metrologjinë. 4. Në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme për një periudhë më të gjatë se 1 muaj, operatorët e rrjetit llogarisin vlera reference zëvendësuese, bazuar në metodologjinë e miratuar nga ERE. Periudha e zbatimit të vlerave referuese nuk mund të zgjasë më shumë se 3 muaj. (Theksojmë se, matja e sasisë së energjisë elektrike të hedhur në rrjet për të furnizuar klientin fundor në rastin konkret ankuesin, z. Xh. Sh. (fiktivisht i kualifikuar si abonent), është fiktive pasi në zbatim të VKM-së nr. 1015, datë 27.11.2013, objekti nuk ekziston *de facto* që nga harku kohor 4-8 dhjetor 2013 kur u krye shembja fizike e objektit. Gjithashtu, edhe nëse do konsiderohej situata hipotetike se të dhënat e matjes janë të paarritshme, sërish shoqëria që furnizon me shërbimin universal të energjisë elektrike është në pozita abuzive pasi në ditët e sotme janë 12 vjet që matja konsiderohet e realizueshme me vlera referuese (ku konkretisht energjia aktive është 0) edhe pse sipas dispozitës kjo periudhë nuk mund të zgjasë më shumë se 3 muaj.)
- Neni 78 “Sistemet matëse inteligjente”, parashikon se: “Në veprimtarinë e matjes së energjisë elektrike mund të implementohen sisteme matëse inteligjente tek klientët fundorë. 2. Operatori i sistemit të shpërndarjes, brenda 1 viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përgatit vlerësimin ekonomik i cili duhet të marrë në konsideratë të gjitha kostot afatgjata dhe përfitimet që do të ketë tregu dhe klientët, duke përfshirë gjithashtu edhe formën e matjes inteligjente që do të përzgjidhet, e cila duhet të jetë ekonomikisht më efektive dhe me afatin kohor më të përshtatshëm për implementimin e këtij sistemi matjeje. 3. Në bazë të vlerësimit të përcaktuar në pikën 2, operatori i sistemit të shpërndarjes përgatit një kalendar për implementimin brenda një periudhë 10-vjeçare të sistemeve inteligjente të matjes, i cili miratohet nga ministri përgjegjës për energjinë.

⁶ <https://www.qbz.gov.al/eli/ligj/2015/04/30/43/e4773fe6-eaaf-42ae-848e-1873da3b391e;q=ligji%20nr.%2043%20date%2030.04.2015>

4. ERE siguron ndërveprimin e sistemeve të ndryshme matëse, që do të implementohen në gjithë territorin e vendit.” (Sjellim në vëmendje se, efektivisht as këtu nuk mund të qëndrojë logjika se është realizuar implementimi dhe ndërveprimi i sistemeve të ndryshme matëse për 78 kontratat e aktivizuara më 17-18 korrik 2013, pasi zbatimi i VKM-së nr. 1015, datë 27.11.2013 është realizuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, dhe rrjedhimisht janë çinstaluar/hequr fizikisht 78 matësat inteligjent të rrymës, energjisë aktive. Ndërveprimi i sistemeve të ndryshme matëse, thënë më thjeshtë që matësat e instaluar në kohën e çeljes së 78 kontratave në ditët e sotme duhet të njihen nga sistemet, aparaturat, e tjera inteligjente të instaluar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe të ndërveprojnë me njëra tjetrën për matjen dhe shpërndarjen e energjisë elektrike deri tek klienti fundor. Pra i gjithë ky “komunikimi” i sistemit në nivel makro (rrjeti shpërndarës në shkallë vendi) me atë në nivel mikro (rrjeti tek klienti fundor), lexohet dhe përkthehet nga sistemi mPower ku deshifron konsumin e rrymës aktive të energjisë elektrike në faturë të konsumit të kësaj energjie për t’u paguar më pas nga abonenti, klienti fundor që e ka kryer këtë konsum. Sërish theksojmë se, edhe në këtë pikë, ky “komunikim” në ditët e sotme për këto 78 kontrata nuk ekziston, pasi nuk ka konsum të energjisë aktive, matësat inteligjent fizik për 78 kontratat nuk ekzistojnë dhe rrjedhimisht nuk merret as shërbimi përkatës.)

- neni 81 “Detyrimet e furnizuesve”, në pikën 4, parashikon se: “Furnizuesit nëpërmjet faturës së konsumit të energjisë elektrike dhe/apo materialeve promo-vuese, informon në mënyrë të qartë klientët për: a) të dhëna për çdo burim energjie të siguruar nga furnizuesi gjatë vitit të mëparshëm; b) elementet përbërëse të çmimit dhe kostot përkatëse; c) të dhënat për ndikimin në mjedis të gazit karbonik dhe mbeturinave radioaktive të emetuara gjatë prodhimit të energjisë elektrike, të siguruar nga furnizuesi në vitin e mëparshëm.” (Nga parashikimi i kësaj dispozite theksojmë se, referuar edhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga FSHU Vlorë sh.a. lidhur me të dhënat fiktive që gjeneron sistemi mPower për 78 kontratat e aktivizuara më 17-18 korrik 2013, rezulton se Furnizuesi informon që vlera monetare e konsumit të energjisë elektrike është 0 (zero), ndërsa mbi elementet përbërëse të çmimit dhe kostot përkatëse rezulton që totali i faturave të papaguara është 0 (zero). Por i vetmi element përbërës i faturës që i debitohet fiktivisht gjeneraliteteve Xh. Sh. është shumatorja e vlerës prej 240 lekë tarifë fikse shërbimi (ku ka të përfshirë TVSH-në) dhe 100 lekë taksë për TV(për aparat televiziv).

Risjellim në vëmendje shkresën nr. 1167/1 prot., datë 07.05.2025, Drejtoria e çështjeve konsumatorë, në Entin Rregullator të Energjisë, me anë të së cilës na informon se: “...**Lidhur me detyrimin kontraktual prej 240 lekë/muaj**, ju sqarojmë se ky detyrim është i miratuar në përputhje me vendimet përkatëse të Bordit të ERE-së për çmimet dhe tarifat e energjisë elektrike, të bazuara në “Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, miratuar me Vendimin nr. 182, datë 16.11.2017. Konkretisht kjo tarifë është e njohur si tarifa fikse e shërbimit për leximin zero, dhe vlera e miratuar nga ERE, pa llogaritur TVSH është në masën e 200 lekë në muaj. Ky tarifim përfaqëson një tarifë fikse mujore për shërbimet e shpërndarjes dhe është e zbatueshme për të gjithë përdoruesit e rrjetit të shpërndarjes në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

Fakti që vetë ERE përcakton se detyrimi kontraktual prej 240 lekë/muaj përfaqëson një tarifë fikse mujore për shërbimet e shpërndarjes, ku në rastin konkret nuk ka asnjë rryme energjie aktive ku të jetë shpërndarë dhe konsumuar nga këto 78 kontrata me gjeneralitetet e z. Xh. Sh., është një materializim tjetër i shkeljes flagrante të parashikimit ligjor të sipërcituar. Shoqëria duhet të kishte bërë zgjidhjen e njëanshme të kontratës sikurse e parashikon Neni 700 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë “*Pala kontraktuese mund të njoftojë me shkrim palën tjetër që nuk ka përmbushur detyrimin, që ta përmbushë atë në një afat të përshtatshëm, duke deklaruar se, **po qe se pas këtij afati kontrata nuk ekzekutohet, ajo do të quhet patjetër e zgjidhur**”.*

Edhe nëse shoqëria përgjegjëse nuk pranon njohjen e parashikimeve ligjore për zgjidhje të kontratës në mënyrë të njëanshme, atëherë kjo shoqëri që ofron shërbimin e furnizimit universal me energji elektrike do duhet t’i drejtohet pronarit aktual, pronarit shtet dhe jo ish-pronarit, z. Xh. Sh. që forcërisht i është hequr e drejta e pronësisë në zbatim të VKM-së nr. 1015, datë 27.11.2013 “Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, objektet, që preken nga rehabilitimi mjedisor i vijës së mbrojtur bregdetare, Ujë i Ftohtë - tuneli, Bashkia e Vlorës”.

Nisur nga sa kemi parashtruar më sipër, është e pa pranueshme që pas zbatimit të VKM-së nr. 1015, datë 27.11.2013 “Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, objektet, që preken nga rehabilitimi mjedisor i vijës së mbrojtur bregdetare, Ujë i Ftohtë - tuneli, Bashkia e Vlorës”, të vijohet të aplikohen këto tarifa mbi një objekt që nuk ekziston *de jure* dhe *de facto* dhe për më tepër për llogari të një subjekti i cili ka humbur çdo të drejtë ligjore pronësie mbi objektin, pasi është shpronësuar (sipas VKM-së përkatëse) dhe në ditët e sotme pronari rezulton të jetë shteti .

Edhe në kuptim të ngushtë të ligjit nr. 92/2014 për at kohë sa furnizimi i shërbimit për 78 kontrata e lidhura më 17-18 korrik 2013 nuk është kryer, rrjedhimisht nuk mund të emetohet faturë tatimore për të cilën TVSH-ja bëhet e kërkueshme. Në këto kushte konkludohet se ankuesi **edhe pse fiktiv si abonent** në sistemin mPower, ku linjat rezulton e hapur, por pa asnjë marrje furnizim shërbimi, pa asnjë konsum të energjisë aktive elektrike, nuk ka asnjë detyrim të paguajë për parregullsitë e shkaktuara nga personat përgjegjës të administrimit të sistemit.

2.6. Lidhur me veprimet e parregullta dhe mosveprimet e personave përgjegjës

2.6.1 Mbajtja në mënyrë të parregullt e ankuesit si abonent fiktiv në sistemin mPower për 78 kontratat objekt trajtimi në këtë rast

Të gjithë sa përmendur e parashtruar përgjatë gjithë trajtesës dhe analizës sonë, mungesa e veprimit për korrigjimin e të dhënave në sistem nga institucionet përgjegjëse, pra të gabimit material nga këto të fundit, përbën një shkelje të parimit të proporcionalitetit dhe efektivitetit të administratës. Rrjedhimisht, mosveprimi i shoqërive dhe autoriteteve përgjegjëse përbën jo

vetëm mosrespektim të nenit 112 të K.Pr.A, por edhe një mungesë vullneti administrativ për të ndrequr një padrejtësi të dokumentuar dhe të shmangshme. Më tej, neni 112 i KPrA-së nuk përmban asnjë kufizim kohor për korrigjimin e gabimeve materiale, pikërisht për të shmangur situata ku qytetarët dëmtohen për shkak të pasaktësive edhe të organeve që veprojnë për llogari administratës publike. Kjo nënkupton se, detyrimi për të vepruar në këtë rast nuk është fakultativ, por një obligim pozitiv i organit publik për të përmirësuar një akt të gabuar që prodhon pasoja të padrejta.

Bazuar dhe në nenin 15 “Parimi i përgjegjësisë” i KPrA-së, i cili ka për qëllim ndër të tjera të qartësojë se organet publike dhe punonjësit e tyre janë përgjegjës për dëmet e shkaktuara ndaj palëve të treta.

Rikujtojmë dhe theksojmë faktin se zbatimi i VKM-së nr. 1015, datë 27.11.2013, për efektet që shkaktoi bëri që ky demolim të amplifikohet edhe mediatikisht, pra nga institucionet e medias informuese të pavarura janë transmetuar daljet publike në atë kohë të figurave publike që ushtronin funksione të larta drejtuese “...14. Më 28 nëntor 2013, ..., Kryeministri deklaroi publikisht se qeveria synonte të realizonte një projekt për ndërtimin e Lungomares, një shëtitore pranë bregut të detit në Vlorë...”⁷, por edhe institucioni i Avokatit të Popullit⁸ në atë kohë ka nxjerrë Rekomandimin e tij lidhur me aspekte procedurale të zbatimit të VKM-së nr. 1015, datë 27.11.2013 ndaj bashkëpronarëve të objektit të shpronësuar në të cilin kanë qenë të instaluar matësat e 78 kontratave ku në mënyrë fiktive ankuesi, z. Xh. Sh., nga shoqëria juaj vazhdon të rezultojë të kualifikohet ligjërisht si debitor.

Kjo përgjegjësi e personave dhe strukturave të ngarkuara për monitorimin e rakordimit në realitet të matësve fizik, gjendjen reale të konsumit të energjisë elektrike si energji aktive, zbatimit të kontratave, si dhe përputhshmëria e kontratave me të dhënat e sistemi, ngre shqetësime në lidhje me (mos)kryerjen e auditimeve nga grupe pune të brendshme apo të jashtme (përveç auditimit që mund të kryejë Kontrolli i Lartë i Shtetit i cili ka tjetër fokus) të kësaj shoqërie mbi pasqyrimin e saktë të krediteve apo debive që mbart kjo shoqëri. Një auditim (kontroll) i tillë do të nxirte në pah çdo vlerë debie të krijuar në raport me konsumatorin fundor, nëse ky i fundit është real apo fiktiv i mbartur, pasi një situatë e tillë, sikurse rasti konkret, nuk mund të jetë aspak e justifikueshme dhe e pranueshme në gjenerim fiktiv të faturimit debitor mbi konsumin e energjisë elektrike. Në të kundërt kjo përkthehet në abuzim dhe rritjen fiktive të vlerave negative në terma financiarë të bilancit të shoqërisë, pra kjo shoqëri rezulton fiktivisht me humbje. Për sa, në refuzim të plotë të bashkëpunimit me Avokatin e Popullit, nuk na është vendosur në dispozicion asnjë informacion apo dokumentacion i cili të vërtetojë mënyrën se si funksionon ky mekanizëm kontrolli brenda

⁷ Çështja Sharxhi dhe të tjerët Kundër Shqipërisë (Vendim, Strasburg 11 Janar 2018, i Formës së Prerë 28.5.2018) <https://www.avokaturashetit.gov.al/vendimet-e-strasburgut/vendimet-e-gjykates-evropiane-per-te-drejtave-te-njeriut-strasburg>

⁸ faqe nr. 63 e Raportit të veprimtarisë institucionale të Avokatit të Popullit për vitin 2013 <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20AP%202013%20anglisht.pdf>

strukturave të shoqërisë, megjithatë, nga raportet publike të KLSH⁹ evidentohet ndër të tjera edhe problematika lidhur me mosrealizimin e auditimeve të brendshme nga strukturat përkatëse.

Po ashtu, vërehet me shumë shqetësim mungesë koordinimi dhe shmangie e përgjegjësisë nga institucionet. Sjellja e deritanishme e organeve përgjegjëse përbën shkelje të parimit të miradministrimit dhe cenon besimin e publikut tek institucionet. Ky parim, i njohur si në jurisprudencën evropiane ashtu edhe në Kartën e të Drejtave Themelore të BE (neni 41), kërkon nga administrata publike veprim të përgjegjshëm, efektiv dhe të bashkërenduar në shërbim të qytetarit. Në këtë rast, kemi një shembull të qartë të keqadministrimit.

Nga ana tjetër, edhe në situatën hipotetike ku abonenti fiktiv shpreh vullnetin për t'u paraqitur pranë sporteleve të përfaqësive tuaja, ndryshe të quajtura sporteli i Kujdesit ndaj Klientit (KNK), për të bërë mbyllje të këtyre kontratave të cilat vazhdojnë e gjenerojnë fatura fiktive nga sistemi mPower, do duhet të ndjekë disa hapa.

Konkretisht, sipas matricës¹⁰ së dokumentacionit, të publikuar në web faqe zyrtare të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), që liston se cilat janë dokumentet që duhet të prezantohen për “Kërkesë për mbyllje të kontratës ose Pezullim”, me kod K011, janë: - Plotësohet Formulari në Qendër Shërbimi; - Mjet Identifikimi;...- Pronësia mbi Objektivin (Kopje e dokument të pronësisë ose e Lejes së Ndërtimit, që mund të jetë kontratë shitblerje, vërtetim hipotekor/certifikatë pronësie, akt qeraje, akt dhurimi ose akt ndarje pronësie të patundshme, dokumente legalizimi, etj). Gjithashtu, operatori i ngarkuar me detyrë për hedhjen e të dhënave në sistem për të plotësuar Kërkesën për mbylljen e kontratës, ndjek hapat e caktuar në zbatim të Udhëzimeve Operacional të Punës, përgjegjësi e Departamentit të Menaxhimit të Kontratave, ku parashkon se për Mbyllje përfundimtare të kontratës, dokumentacioni bashkëlidhur aplikimit është: 1. aplikimi; 2. Procesverbal i saktë i verifikimit dhe foto të qarta; 3. ID e titullarit;...5. Dokumenti i lidhjes me pronën...

Pra, edhe nëse ankuesi i cili është kualifikuar fiktivisht si abonenti do të paraqitej pranë sporteleve tuaja për mbyllje kontrate sikurse mund të kërkohej, sërish kjo procedurë është objektivisht e përealizueshme për 78 kontratat e çelura më datë 17-18 korrik 2013 me gjeneralitetet Xh. Sh., pasi zbatimi i VKM-së nr. 1015, datë 27.11.203 e ka shpronësuar menjëherë atë, së pari pronari është shtet, dhe jo më ankuesi z. Xh. Sh., dhe së dyti objekti për të cilin kërkohen fotot e qarta nuk ekziston de jure dhe de facto.

Në konkluzion të sa u parashtrua dhe arsyetua deri më tani, vlerësojmë se sjellja e shoqërive dhe organeve përgjegjëse përkundrejt ankuesit por edhe përkundrejt adresimit të situatës në tërësi nuk garanton standardin e nevojshëm për ofrimin e shërbimit universal në nivel sa më afër qytetarëve.

⁹ Raport Përfundimtar Auditimi “Mbi Përputhshmërinë” në Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group Sh.A Korrik, 2023, <https://www.klsh.org.al/wp-content/uploads/2025/02/Raport-perfundimtar-i-auditimit-ne-Operatorin-e-Shperndarjes-se-Energjise-Elektrike-group-sh.a1.pdf>

¹⁰ <https://oshee.al/wp-content/uploads/2019/10/MATRICA-E-DOKUMENTACIONIT-revised.pdf>

Ankuesi, z. Xh. Sh., në ditët e sotme ndodhet i pozicionuar, nga shoqëritë dhe enti përgjegjës që rregullojnë dhe ofrojnë shpërndarjen dhe shërbimin e furnizimit universal me energji elektrike, në mënyrë të paligjshme si debitor për mospërmushje, mosnjoftim të zgjidhjes së kontratave të çelura më 17-18 korrik 2013 të pasurisë së shpronësuar. Janë krijuar kushtet fiktive ku ankuesi vazhdon e penalizohet për mosnjoftim të një fakti për të cilin prezumohet dijenia për efekt të ligjit.

Për më tepër, është detyrë e shoqërive dhe organeve administrative përgjegjëse që, në përputhje me parimin e përgjegjësisë dhe atë të bashkëpunimit të ndërsjellët ndërinstitutional, të mos i mbyllin rrugën administrative një qytetari të dëmtuar nga gabime të dokumentuara të vetë sistemit të cilin keni në administrim. Institucioni i Avokatit të Popullit e konsideron këtë qasje të papranueshme dhe në kundërshtim me standardet e së drejtës administrative bashkëkohore, e cila vendos në qendër mbrojtjen efektive të individit dhe korrigjimin me përparësi të padrejtësive të shkaktuara nga vetë organet përgjegjëse.

Në vlerësimin tonë, konstatohet se “lejimi i sistemit mPower” të numërojnë të 78 kontratat në fjalë, objekt ankese në shqyrtim, si kontrata aktive është bërë dhe bëhet në mënyrë arbitrare dhe të paargumentuar, si dhe në kundërshtim me të drejtën dhe të interesave ekonomike të konsumatorit, të ankuesit z. Xh. Sh., në kuptim edhe të ligjit nr.9902, datë 17.4.2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”.

2.6.2. Mosbashkëpunimi me Avokatin e Popullit

Lidhur me rastin objekt trajtimi, sikurse e theksuam më lart në përmbajtjen e këtij rekomandimi rezulton se në përgjigje të kërkesave për shpjegime drejtuar Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a, Tiranë, Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a, Tiranë, Entit Rregullator të Energjisë (ERE) si dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a, Rajoni Vlorë, vetëm ERE dhe FSHU Vlorë kanë kthyer përgjigje, ndërsa nga pjesa tjetër e institucioneve nuk pati përgjigje zyrtare. Megjithatë, edhe informacioni i përcjellë nga këto dy organe ka qënë i pjesshëm, duke mos i përgjigjur plotësisht dhe në mënyrë shteruese kërkesave të adresuara nga Avokati i Popullit. Ky qëndrim i mbajtur nga personat përgjegjës, punonjës në shoqëritë e sipërpërmendura, ka sjellë pengesë në kryerjen e misionit kushtetues e ligjor të Avokatit të Popullit, për mbrojtjen e të drejtave, lirive të shtetasve dhe interesave të tyre të ligjshme.

Legjislatori ka parashikuar si veçori themelore të institucionit të Avokatit të Popullit, veç pavarësisë nga institucionet e tjera dhe nga çdo ndikim politik, lehtësinë e kontaktimit, shpejtësinë dhe fleksibilitetin në trajtimin e problemeve, si dhe mungesën e shpenzimeve, pasi veprimtaria e tij është pa pagesë.

Mungesa e informacionit dhe dokumentacionit, si dhe dërgimi i përgjigjeve të pjesshme, të pasakta, apo tej afatit të përcaktuar dhe atij të arsyeshëm ligjor, sjell zvarritjen e procesit administrativ dhe mohimin e të drejtës së qytetarëve për të gëzuar efektivisht të drejtat e tyre kushtetuese dhe për të përdorur mekanizmat kushtetues për garantimin e tyre. Kjo gjithashtu

minon besimin e qytetarëve tek shteti dhe administrata shtetërore ndërkohë që, të gjitha përpjekjet në nivel evropian por edhe të Këshillit të Evropës, janë të drejtuara për nga ruajtja e besimit të publikut dhe përmirësimi i këtij indikator.

Megjithatë, krahas detyrimit të përgjithshëm për informim dhe transparencë që kanë organet publike përkundrejt palëve të treta, theksojmë se detyrimi për bashkëpunim me Avokatin e Popullit, gjatë hetimit administrativ, veçse një detyrim i karakterit administrativ është një detyrim kushtetues, për nga vetë specifika që ka ky organ publik.

Bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ është i lidhur ngushtësisht me parimin e transparencës dhe atë të llogaridhënies. Organet e administratës publike janë të detyruara të bashkëpunojnë për të mbështetur organin publik që kryen hetimin administrativ në funksion të përcaktimit të fakteve dhe rrethanave të çështjes. Transparenca dhe llogaridhënia janë dy nga parimet kryesore të mirëqeverisjes në administratën publike.

Misioni i institucionit të Avokatit të Popullit në këtë drejtim është të kontribuojë në transparencën dhe llogaridhënien e organeve publike, sa i përket ushtrimit të veprimtarisë administrative nga ana e tyre.

Referuar problematikës së hasur në këtë rast, me personat përgjegjës në respektim të afateve procedurale të kthimit të përgjigjes, institucioni i Avokatit të Popullit kërkon nga FSHU sh.a dhe OSSH sh.a, titullarët e këtyre shoqërive, të vlerësojnë në përputhje me ligjin organik dhe Kodin e Procedurave Administrative, veprimtarinë e personave përgjegjës mbi respektimin e afateve procedurale në shqyrtim të akteve si dhe ofrimin e shërbimeve konform legjislacionit aktual.

3. Konkluzione dhe rekomandime

Në përfundim të analizës, hetimit dhe vlerësimit të kësaj çështje, Avokati i Popullit vlerëson dhe konstaton se rasti paraqet një kompleksitet problematikash të lidhura me mosveprimin, moszbatimin e duhur të legjislacionit në fuqi ndër vite.

Parregullsi në administrimin e kontratave të abonentëve të shoqërisë që ofron shërbimin e furnizimit me energji elektrike, e cila ka passjellë shkelje të kushteve kontraktuale.

Gjithashtu edhe mënyra e përdorimit në mënyrë aspak korrekte, thuajse abuzive, e sistemit mPower me anë të së cilit menaxhohen matjet e konsumit të energjisë elektrike të kontratave të abonentëve, ka krijuar hapësira për keqadministrimin dhe abuzim flagrant të trajtimit të abonentit për 78 kontratat e çelura më datë 17-18 korrik 2013 me gjeneralitetet Xh. Sh., ndaj, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 63/3, në të cilin thuhet se : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga administrata publike”, si dhe në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar, neni 21/b në të cilin thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme të heqjes së statusit si abonent debitor nga sistemi i menaxhimit të abonentëve të shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a., të ankuesit z. Xh. Sh., për shkak të krijimit të matjeve fiktive të bëra në sistemin mPower për 78 kontrata të çelura më datë 17-18 korrik 2013 me gjeneralitetet Xh. Sh..
2. Marrjen e masave të menjëhershme për korrigjim, rregullim dhe çaktivizim nga sistemi i matjes së konsumit të energjisë elektrike mPower për 78 kontratat e aktivizuara më 17-18 korrik 2013, me gjeneralitet Xh. Sh., të kategorisë familjare, me fuqi 5/7 KË, në Qarkun e Vlorës, nën zona A, nënstationi N/ST 35/6 UJ.F|VL V 148, me fider Q1|R549, kabina Plazhi i Ri, Prodhuesi OSHEE, Kapaciteti: 20-25 Amp, Fazë 1, Koeficienti matës: 1, Grupi: Mobi Read, Shënime të vjetra: Lidhje e Re. 17.7.13.I.C.PR.10273 (për kontratat e lidhura më 17.07.2013) dhe Lidhje e Re. 18.7.13.I.C.PR.10273 (për kontratat e lidhura më 18.07.2013)
3. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e detyrimit ligjor, për dhënien e informacionit Avokatit të Popullit.
4. Fillimin e procedurës administrative, për evidentimin e punonjësve përkatës përgjegjës, të Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, lidhur me mospërmbushjen e detyrimit ligjor, për t'i kthyer përgjigje kërkesave të Avokatit të Popullit, për dërgimin e informacionit të kërkuar, si dhe marrjen e masave administrative e disiplinore ndaj tyre.

Për qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi si dhe masat disiplinore që do të merrni, na vini në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh, konform nenit 22, të ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “ Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

KOMISIONERE

Vilma SHURDHA

d.v